



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 15 Prot.

Tiranë, më 06/01/2015

REKOMANDIM

Nr. 03 / datë 06/01/2015

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, si dhe neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

KONSTATOVA :

Në zbatim të Urdhërit nr. 208, datë 25.11.2014 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është kryer kontrolli administrativ pranë kontrolluesit “Ministria e Integritimit Evropian” me objekt:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, gjatë kryerjes së aktivitetit të tij.

Ministria e Integritimit Evropian në kuptim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar është kontrollues publik. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë mbledh dhe përpunon të dhëna personale gjatë aktivitetit të tij për kategorinë nëpunës.

Komisioneri konstaton se kontrolluesi MIE mbledh dhe përpunon të dhëna personale vetëm për kategorinë nëpunës nëpërmjet Drejtorisë së Burimeve Njerëzore. Për kategorinë nëpunës kontrolluesi mbledh këto të dhëna: emër, atësi, mbiemër, datëlindje, vendlindje, formimi diplomat, të dhëna për shëndetin, CV. Këto të dhëna mblidhen në bazë dhe në zbatim të VKM-së nr. 117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

Gjithashtu në këtë VKM përcaktohen rregulla mbi mënyrën e përpunimit dhe ruajtjen e të dhënave personale të nëpunësve, ku parashikohet karakteri konfidencial i të dhënave të nëpunësve, të drejtat e aksesit mbi këto të dhëna si dhe faktin e kthimit të dosjes personale të nëpunësit me ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Komisioneri konstaton se kontrolluesi i ka marrë të gjitha masat e sigurisë fizike duke garantuar mbrojtjen e të dhënave personale.

Për sa i përket Drejtorisë për Politikat Sektoriale, Drejtorisë së Ligjeve të Bashkimit Evropian, Drejtorisë së Jetësimit të Prioriteteve dhe Sekretariati, Drejtorisë së Programimit të Asistencës së Be-së dhe Drejtorisë së Monitorimit të Projekteve të BE-së, Komisioneri konstaton se këto drejtori nuk përpunonin të dhëna personale por kishin si qëllim të veprimtarisë së tyre bashkërendimin e procesit të integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian nëpërmjet hartimit të politikave, përafrimit të legjislacionit dhe koordinimit të veprimtarive integruese.

Komisioneri konstaton se kontrolluesi MIE në faqen e tij në internet www.integrimi.gov.al nuk ka publikuar “politika të privatësisë”, me qëllim informimin e personave që vizitojnë faqen, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, masat e sigurisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë, në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Kontrolluesi MIE në momentin e ushtrimit të kontrollit administrativ nuk e kishte realizuar detyrimin për njoftim, në zbatim të nenit 21 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Pas lënies së proces-verbalit rezulton se kontrolluesi MIE e ka realizuar detyrimin për njoftim, (vërtetuar nga regjistri elektronik online i Zyrës së Komisionerit).

Komisioneri konstaton se kontrolluesi nuk ka hartuar një rregullore të veçantë për mbledhjen, mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen e të dhënave personale, në zbatim të neneve 27, 28 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Në përfundim të hetimit administrativ kontrolluesi u njoh me konstatimet e grupit të punës nëpërmjet procesverbalit të datës 23.12.2014 të kontrollit administrativ si më poshtë:

- 1- Kontrolluesi në faqen e tij në internet www.integrimi.gov.al nuk ka publikuar “politika të privatësisë”, me qëllim informimin e personave që vizitojnë faqen, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, masat e sigurisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë, në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.
- 2- Kontrolluesi nuk ka rregulla të përfshira në rregulloren e brendshme apo rregullore të veçantë lidhur me përpunimin e të dhënave personale, sigurinë dhe konfidencialitetin, në zbatim të nenit 27 dhe 28 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Për sa më sipër:

Në zbatim të neneve 18, 27, 28, 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të Kodit të Procedurave Administrative,

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, në faqen zyrtare në internet të kontrolluesit www.integrimit.gov.al, të publikohen në një rubrikë të veçantë “politikat e privatësisë”, me qëllim informimin e personave që vizitojnë faqen, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, masat e sigurisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.
2. Në zbatim të neneve 27, 28 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të merren masa për hartimin e një rregullore të shkruar për mbledhjen, mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen e të dhënave personale. (Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare www.idp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë).
3. Kryerja e këtyre detyrimeve të realizohet brenda një afati kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga momenti i marrjes dijeni të këtij rekomandimi.
4. Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionierit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
5. Me kalimin e këtij afati në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vendos sanksione për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

